



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 76 Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 14/ 05 / 2025

VENDIM

Nr.18, date 14 /05/2025

PËR

**MIRATIMIN E MARREVESHJES SE BASHKEPUNIMIT NDERMJET KOMITETIT
KOMBETAR TE DIGAVE TE MEDHA NE SHQIPERISE (KKDM)
DHE ORGANIZATES JOFITIMPRURESE "H2H FOUNDATION"**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave", Neni 4, pika a,c,d, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 14.05.2024 mori në shqyrtim Marreveshjen e Bashkepunimit ndermjet KKDM dhe H2H Foundation te paraqitur nga Kryetari i KKDM, z. Arjan Jovani.

Përmes kësaj Marreveshje te Bashkepunimit synohet vendosja e një bashkëpunimi afatgjatë dhe institucional midis organizates jofitim prurese H2H Foundation dhe KKDM per shkëmbimin e njohurive teknike dhe ekipeve të specializuara dhe të kualifikuara në fushën përkatëse përmes një bashkëpunimi me interes të përbashkët; Informimi reciprok mbi të rejat dhe zhvillimet e sektorit te digave te mëdha dhe më gjërë që paraqesin interes për aktivitetin institucional të Palëve; Shkëmbim të botimeve, rezultateve të punës studimore dhe shkencore, të dokumentacionit teknik informues dhe shkencor, standardeve teknike dhe udhëzuesve teknike të domosdoshëm për projektimin, monitorimin, shfrytëzimin dhe sigurinë e digave të mëdha të vendit, në përputhje me standardet bashkëkohore Europiane dhe ato të miratuara nga Komisioni Ndërkombëtar për Digat e Mëdha (ICOLD); Organizimi i veprimtarive të përbashkëta shkencore: konferenca, konsultime dhe seminare për çështje të sigurise se digave e të lidhura me to; për nderimin, vlerësimin dhe evokimin e meritave të figurave të shquara të inxhinierisë në fushën e projektimit dhe ndërtimit të digave si dhe bërjen të njohur të rëndësisë shkencore dhe ekonomike të veprave të mëdha ujore të sistemit unik energjetik, bujqësor dhe ujit të pijshëm; Nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e veprimtarive të përbashkëta me interes reciprok.

Pas diskutimeve të të gjithë antarëve te pranishem, KKDM

VENDOSI:

Të miratoj Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha te Shqipërise (KKDM) dhe Organizatës jofitim prurëse "H2H Foundation" sipas tekstit bashkëlidhur ketij Vendimi.

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për arkivimin e kesaj Marreveshje si dhe ndjekjen dhe zbatimin e detyrimeve te percaktuara ne kete dokument , ne perputhje me legjislacionin në fuqi. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI
Arjan JOVANI

